

Terapia psikomotorike

Një ofertë e pedagogjisë speciale nga qyteti i Cyrihut

Çfarë është terapia psikomotorike?

Kjo terapi është një shërbim mbështetës për fëmijët që kanë vështirësi në të lëvizur. Terapia psikomotorike e kupton zhvillimin e fëmijës si një tërësi të **të lëvizurit, përjetimit, të menduarit, ndjenjës dhe veprimit**. Duke luajtur fëmija krijon një lidhje midis lëvizjeve, botës së tij të ndjenjave dhe të të menduarit. Termi "aftësi psiko-motorikë" thekson lidhjen midis proceseve motorike dhe psiqike. Njerëzit të cilët lëvizin, janë të përfshirë me gjithë personalitetin e tyre në procesin e lëvizjes.

1.1.1 Cilët fëmijë marrin pjesë në terapinë psikomotorike?

Jo të gjithë fëmijët janë njësoj. Zhvillimi i të lëvizurit së fëmijëve ka një gamë të gjerë variacionesh. Çdo fëmijë ka anët e forta dhe të dobëta të tij, interesa dhe pririje të veçanta. Te disa fëmijë bien qartë në sy disa veprime të ndryshme në lëvizje, në perceptim dhe në sjellje. Kjo shfaqet nëpërmjet:

- zhvillimit të ngadalësuar të lëvizjes
- ngathtësisë
- aktivitetit dhe impulsivitetit të tepërt
- frenimit të lëvizjes
- anomalitë në zhvillimin e të shkruarit (aftësitë grafomotorike)

Anomalitë në mënyrën e të lëvizurit shpesh mund të jenë të lidhura me probleme në fushën e zhvillimit social, emocional dhe konjitiv dhe mund të shfaqen si vijon:

- vështirësi në përpunimin e dështimeve (tolerancë e ulët e frustracionit)
- vështirësi në marrëdhëniet me fëmijë të tjerë
- sjellje agresive
- sjellje foshnjore
- vetëbesim i ulët
- kontroll i vështirë i përqendrimit
- probleme në të mësuar dhe dobësi në aftësi të veçanta.

Fëmijëve, zhvillimi i të cilëve cenohet nga vështirësitë e sipërpërmendura, terapia psikomotorike u ofron mbështetje të përshtatur sipas nevojave të tyre.

Çfarë përjetojnë dhe mësojnë fëmijët në terapinë psikomotorike?

Me një shumëllojshmëri lojërash dhe materialesh mësimore, fëmija gjen një ambient tepër stimulues mësimor. Gjatë terapisë psikomotorike fëmija vë në përdorim anët e tij pozitive dhe interesat e tij të veçanta, dhe këtë në forma konkrete të lojërave dhe të veprimit.

Fëmija mëson sipas vendimit të vet dhe me motivacion. Përjetimet e sukseseve forcojnë vetëbesimin dhe motivimin e tij për të mësuar.

Përjetimet aktive dhe pasive të të lëvizurit dhe **zbulime** e **përvojat** e pavarura janë elementë të rëndësishëm të zhvillimit të fëmijës.

Të parët, të dëgjuarit dhe të prekurit, por edhe perceptimi i trupit dhe i lëvizjes si dhe shqisa e ekuilibrit janë të lidhur ngushtë me lëvizjen dhe luajnë një rol kyç në terapinë e ndjekur.

Nëpërmjet mënyrës si mban trupin, me mimikën dhe gjestet e tij fëmija **shpreh ndjenjat**.

Procesi i lojës formon një bazë të rëndësishme për një veprim të pavarur dhe të përshtatshëm në jetën e përditshme dhe është një element i rëndësishëm në mbështetjen e terapisë psikomotorike.

Terapistja ofron aktivitete stimuluuese, të cilat përputhen me çdo fëmijë, me të cilat fëmija mund të **praktikojë dhe përmirësojë** lëvizjet. Kjo bëhet në fushat: motorika e trashë, motorika e imët dhe grafomotorika.

Terapia grafomotorike e ndihmon fëmijën në zhvillimin e shkrimit të dorës dhe nxit aftësinë e tij të shkrimit. Këtu përfshihen edhe drejtimi dhe konsultimi lidhur me problemet e qenies mëngjarash dhe të zhvillimit problematik të përdorimit të dorës së preferuar.

Objektivat: Terapia psikomotorike u ofron fëmijëve nxitje në fushën e të lëvizurit dhe të perceptimit dhe i përkrah ata në zhvillimin e kompetencave të tyre sociale. Fëmijët zhvillojnë strategji të reja dhe rrugëzgjdhje personale në mënyrën e trajtimit të problemeve. Vetëbesimi i tyre forcohet dhe ata i dalin zot më mirë jetës së përditshme.

2. Cilat janë fushat e veprimtarisë së terapistit së psikomotorikës?

Shqyrtimi: Terapistja e psikomotorikës trajton gjendjen e zhvillimit të motorikës së trashë, të asaj të imët dhe të grafomotorikës si dhe gjendjen e sjelljes për fëmijët e regjistruar. Ajo realizon një proces shqyrtimi të diferencuar, si dhe vëzhgon fëmijën në situata loje dhe lëvizjesh të lira si dhe të organizuara. Në këtë pikë përfshihen edhe bisedat informuese me personat me të rëndësishëm referues (prindërit dhe edukatorët).

Terapistja u shpjegon prindërve dhe edukatorëve të fëmijës vëzhgimet dhe vlerësimet e kryera prej saj. Objektivat stimulues diskutohen dhe vendosen bashkërisht.

Terapia: Duke u bazuar në fazën e sqarimit, terapistja bashkë me prindërit dhe edukatorët përcaktojnë objektivat e terapisë psikomotorike. Duke iu referuar këtyre objektiveve ajo më pas realizon terapinë. Bashkë me prindërit dhe edukatorët e fëmijës ajo kërkon mënyra se si këta mund ta mbështesin terapinë. Në takimet një herë në gjashtë muaj, bashkë me të gjithë të përfshirët, testohen objektivat stimulues.

Konsultim profesional, Masat parandaluese: Terapistja vendos gjithë njohuritë e saj profesionale në dispozicion të edukatorëve të veçantë apo dhe të të gjithë shkollës. Ajo bashkëpunon me mësuesit ose realizon projekte mbështetëse me të gjitha klasat apo me grupet e fëmijëve (masa parandaluese).

Si pranohet fëmija në terapinë psikomotorike?

Pas konsultimit dhe me pëlqimin e prindërve, mësuesi paraqet një kërkesë për një sqarim profesional në organin kompetent terapeutik për psikomotorik. Pas kësaj fëmija dhe prindërit ftohen nga terapistja përkatëse e psikomotorikës për zhvillimin e procedurës së shqyrtimit psikomotorik. Në një nga takimet shkollore pasardhës terapistja shpjegon rezultatet e procesit të shqyrtimit dhe paraqet një propozim për **terapi, nxitje integrative** respektive. Me pëlqimin e prindërve dhe miratimin e drejtorisë së shkollës regjistrohet edhe terapia, nxitja respektive me fëmijën. Terapia psikomotorike do të financohet nga qyteti i Cyrihut si pjesë e ofertës së pedagogjisë speciale.

Për më shumë informacion:
Fachstelle Psychomotorik-Therapie
Rämistrasse 39
8001 Zürich
Tel. 044 250 22 60

www.stadt-zuerich.ch/psychomotorik-therapie